VENDIM
Nr. 397, datë 11.5.2015

PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SHTETËRORE "KANTIERI I NDËRTIMIT DHE RIPARIMIT TË ANIJEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, "Për ndërmarrjet shtetërore", dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e ndërmarrjes shtetërore "Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve", në vijim KNRA, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. KNRA-ja e ka qendrën (selinë) në Pashaliman, Vlorë.
3. Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj., si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.
4. Territori, inventari dhe çështje të tjera të pronësisë janë përcaktuar sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit, raportit të ekspertit kontabël dhe vlerësimit të pasurive të paluajtshme.
5. Tarifat e shërbimit të mjeteve lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.
6. Riparimi i mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura do të kryhet bazuar në kontratat e lidhura midis palëve dhe sipas një grafiku vjetor. Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara.
7. Përjashtimisht për vitin 2015, KNRA-ja do të kryejë riparimin e mjeteve lundruese të Forcës Detare, pa shpërblim.
8. Shuma e kapitalit themeltar është 2 446 392 291 (dy miliardë e katërqind e dyzet e gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë.
9. Shuma prej 97 874 561 (nëntëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh transferohet nga Komanda e Forcës Detare Durrës në favor të ndërmarrjes shtetërore "Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve", si shtesë në kapitalin themeltar, sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
10. Paga e drejtorit të KNRA-së është në nivelin 108 780 (njëqind e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, e cila në vijim indeksohet dhe ndryshohet me urdhër të ministrit Mbrojtjes dhe me propozim të Këshillit Drejtues të KNRA-së.
11. Pagat e punonjësve të KNRA-së miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12. Statuti i ndërmarrjes shtetërore "Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve", miratohet nga ministri i Mbrojtjes.
13. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


Deti JON
Deti JON
Inq. Gjergji Ristani
Lic. VP.0106/1

MINISTRIA E MBROJTJES

TABELA E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE NE PROGRAMIN FORCAT E LUFTIMIT PËR KNA PËR VITIN 2015

	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Kapitulli	Emërtimi i institucionit	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Pakësohet	Shtohet
				Forcat e Luftimit	**02120**			**97,874,561**	
001	**17**	**1017009**	**01**	**Reparti ushtarak 2001-Durrës**				**97,874,561**	
001	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare, Durrës	02120	600	0707	38,200,000	
001	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare, Durrës	02120	601	0707	6,303,000	
001	17	1017031	01	Rep.Usht. nr. 2001-KF Detare, Durrës	02120	602	0707	53,371,561	
				Kantieri i Ndërtimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë					**97,874,561**
				Kantieri i Ndërtimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë		604			97,874,561